



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT



Në bazë të nenit 22 paragrafi _ dhe nenit 23 nga Ligji për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 12/2019) dhe nenit 40 dhe 41 nga Rregullorja për punë e Komisionit shtetëror për parandalim të korrupsionit, duke vepruar pas denoncimit nga parashtruesi nga f., Komuna Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit (KSHPK), në seancën e 47 të mbajtur me datë 31.03.2021 morri

VENDIM

Procedura për lëndën numër 12-166 nga viti 2020, e formuar pas denoncimit nr. 12-166/1 me datë 10. 01.2019 dorëzuar nga parashtruesi nga f., Komuna NDËRPRITET.

Në përputhje me dispozitat e Ligjit për parandalim të korrupsionit dhe konfliktit të interesave, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për lëndën me numër 12-166 nga viti 2020, për rastin e lëndës në rrjedhë është procedura pran organi tjetër që është kompetent të vepron në këtë fushë.

Lënda me numër 12-166 nga viti 2020 të mbyllet dhe të arkivohet.

Deri tek parashtruesi i denoncimit të dorëzohet Vendimi i KSHPK, me sqarimin,

Vendimi i KSHPK me sqarimin në formë të depersonalizuar të publikohet në web-faqen e Komisionit shtetëror në afat prej pesë ditë nga dita e marrjes së vendimit.

SQARIM

Lënda me numër 12-166 nga viti 2020 është e formuar pas denoncimit nr. 12-166/1 me datë 10.01.2020, dorëzuar deri tek Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit nga parashtruesi nga f., Komuna

Në denoncim flitet për akuza për joprofesionalizëm dhe veprim korruptiv dhe sjellje të prokurorit publik në Prokurorinë themelore publike dhe gjyqtarit nga Gjykata themelore gjatë veprimit për lëndët të cilat iu janë shpërndarë në punë dhe kërkon që KSHPK të vepron dhe të ngritë procedurë për përgjegjësi të personave të përmendur.

Gjatë shqyrtimit të rastit të lëndës KSHPK i merr parasyshë akuzat e parashtruesit dhe në drejtim të përcaktimit të gjendjes faktike, dorëzoi kërkesë deri tek organet kompetente dhe institucionet për të dhëna dhe informacione në lidhje me rastin e lëndës.

Pas kërkesës së Komisionit shtetëror është dorëzuar informim dhe pas rishikimit të dokumentacionit të plotë për rastin e lëndës, nga ana e KSHPK është vërtetuar gjendja faktike vijuese:

- Në rastin konkret, bëhet fjalë për joprofesionalizëm dhe veprime korruptive dhe sjellje të prokurorit publik në Prokurorinë themelore publike, i cili ka vepruar për lëndën penale KO/..... dhe gjyqtarit nga Gjykata themelore, i cili ka vepruar në lëndën K Akuzat e lëndës janë në lidhje me fatkeqësi komunikacioni e cila ka ndodhur me datë 01.11.2018 në, në të cilën ka pësuar djali i parashtruesit të denoncimit si bashkëudhëtar i mitur

në automobilin që e ka shkaktuar aksidentin, i cili gjatë asaj ka pësuar dëmtime të përhershme turpore dhe ka përfunduar në karrocë invalidore. Në rastin e lëndës, me propozim të prokurorit publik për dhënje të urdhërit të dënimit nga gjyqtari është pranuar propozimi dhe gjyqtari ka shqiptur Aktgjykim për dhënjet të urdhërit të dënimit K.nr./..... me datë 15.11.2018, me të cilën e dënon me dëmin me kusht prej 3 muaj burg, e kushtëzuar në një vitë dhe të paguan shpenzimet e procedurës me paushall në vlerë prej 10.000 denarë.

Parashtruesi i denoncimit nuk është i kënaqur nga veprimi i organeve të rendit dhe aktgjykimi i mitaruar, sipas akuzave të tij ato kan vepruar në mënyrë joprofesionale në rastin e tij dhe aktgjykimi i mitaruar nuk ka qenë ligjore, i drejtë dhe i barabartë sepse ato si palë e kyçur nuk janë ndëgjuar ose të thirrur në gjyq në procedurën gjyqsore të lëndës e cila ka përfunduar pa mos pasur as ndonjë të drejtë në dëm të të akuzuarit. Sipas atij, në rastin është kryer vepër penale me qëllim, sepse me shoferin e automobilin në të cilin ka qenë i biri i tij, ka vozitë me shpejtësi dyfishtë më të madhe nga shpejtësia e lejuar dhe në atë mënyrë ka shkaktuar fatkeqësinë e cila si pasojë ka lënë invaliditet të përhershëm të llojit më të rëndë. Parashtruesi mendon se familjes së tij iu është marrë e drejta nga ana e prokurorisë dhe gjyqit, kurse dëshmi për atë është se edhe aktgjykimin për rastin e kan marrë pas një viti edhe me kërkesë të tij me disa orvajtje deri tek gjyqi dhe prokuroria. Përshkak të pakënaqësisë së tij, në lidhje me këtë rast ka dorëzuar anekës deri te Këshilli i prokurorëve publik dhe deri tek Këshilli gjyqsor i RMV, që të ngritet procedurë për përgjegjësi kundër personave të përmendur, kurse me këtë denoncim deri tek KSHPK kërkon që edhe kjo të vepron në lidhje me rastin e tij dhe të ngritë procedurë për përgjegjësi të personave të përmendur.

- Me datë 13.07.2020, me kërkesë të KSHPK, është dorëzuar informim nga ana e Këshillit gjyqsor i RMV me të cilën informojnë se për ankesën e parashtruar nga personi e cila në Këshillin gjyqsor është e vulosur me numër/..... është formuar lëndë dhe procedura për të njëjtën është në rrjedhë. Pas shqyrtimit të ankesës në senacën e Këshillit gjyqsor, KSHPK në mënyrë plotësuese do të informohet për përfundimin e të njëjtës.
- Me datë 20.07.2020, me kërkesë të KSHPK, është dorëzuar informim nga ana e Këshillit të prokurorëve publik me të cilën informojnë se deri tek Këshilli i prokurorëve publik të RMV është dorëzuar ankesë nga nga f., Komuan në lidhje me veprimin e prokurorit publik në Prokurorinë themelore publike , për lëndën KO. nr. Të kësaj prokurorie. Në ankesë flitet për veprim të pamend dhe joprofessional të këtij prokurori publik, me atë që për veprën penale të kryer, nga ana e personit nga f., me të cilën i biri i tij i mitur ka ngelur me dëmtime të rënda trupore, me diagnostizë përfundimtare – Hemiplegji flakcide dhe është në karrocë invalidore, ka parashtruar propozim për dhënje të urdhër dënimi me aktgjykim në të cilën do të shqiptohet gjykim me kusht, asi Aktgjykimi që i është edhe shqiptuar nga ana e Gjykatës themelore

Këshilli i prokurosëve publik të RMV, duke vepruar për ankesën, kërkoi nga Prokuroria e lartë themelore, si prokurori themelore më e afërt, në përputhje me nenin 21 paragrafi 1 nga Ligji për prokurori publike, të bëjë mbikqyrje në lëndën e PThP

t'i kontrollon akuzat në ankesë dhe për konstatimet e tyre ta informon Këshillim në kohën më të shkurtë të mundshme. Pas marrjes së informacionit nga Prokuroria e lartë publike Këshilli gjeti se për konstatimet në lidhje me veprimin e PthP për lëndën KO. nr. /.... duhet ta informon Prokurorinë themelor të RMV përshkak të ndërmarrjes eventuale të veprimeve ligjore në kuadër të kompetencave të veta, në përputhje me Ligjin për prokurori publike. Përndryshe, Këshilli i prokurorëve publik, në përputhje me Ligjin për prokurori publike dhe ligjin për Këshill të prokurorëve publik nuk është i autorizuar për ngritje të procedurës për vërtetim të përgjegjësisë së prokurorit publik duke pasë parasyshë se i njëjti vepron në shkallën e dytë për ankesa kundër vendimeve të Komisionit për vërtetim të përgjegjësisë së prokurorit publik pranë Prokurorisë publike të RMV. Për veprimet e ndërmarra për ankesën, nga ana e Këshillit të prokurorëve publik, ka qenë i informuar edhe parashtruesi i ankesës, nga f.

Në bazë të kësaj gjendje faktike të vërtetuar, KSHPK konstaton se në lidhje me rastin konkret të lëndës kanë vepruar organe tjera që janë kompetent të veprojnë – Këshilli gjyqsor i RMV, PTH e RMV dhe pranë së cilave procedura ende është në rrjedhë dhe nuk është marrë vendim/aktvendim nga veprimi i tyre kompetent. Duke pasë parasyshë të konstatuarën, KSHPK vlerëson se nuk ka elemente për veprim të mëtutjeshëm për rastin e lëndës, procedura për lëndën ndërpritet dhe lënda të mbyllet dhe të arkivohet.

Duke pasë parasyshë të shënuarën mësipër, Komisioni shtetëror për parandalim të korrupsionit vendosi sipas dispozitave të këtij vendimit.

**KOMISIONI SHTETËROР ПЁР
PARANDALIM ТЁ КОРРУПСИОНИТ**
Kryetarë: Biljana Ivanovska

Dorëzuar deri tek: Arkiva, Parashtruesi
Pas përfundimit të senacës së KSHPK
Përpunoi: J. C.
Miratoi: S. P. D., anëtarë i KSHPK